



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 03.06.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 13, 15, 17, 20, 21, 22, 27 dhe 28 maj 2019.
2. Miratimi i draftkalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 3-21 qershor 2019.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Prokurorit të Përgjithshëm për vitin 2018”.
4. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite, për shërbimet ajrore”.
5. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), për bërjen palë në kuadrin gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar mbi erozionin e bazës së tatueshme dhe transferimin e fitimit (BEPS)”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Elena Xhina, Fatmir Xhafaj, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi dhe Ediola Braha

Mungojnë:

Vasilika Hysi, Edmond Leka, Damian Gjiknuri, Spartak Braho, Alban Zeneli, Andi Permeti, Elda Hoti dhe Tom Doshi

Të ftuar:

Ilir Bejtja – zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Megi Xharo – përgjegjëse e marrëdhënieve me jashtë nga AAC

Lilika Radovicka - përgjegjëse sektori

Erion Luçi – zëvendësministër i Financave

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kuorumi i nevojshëm për fillimin e mbledhjes është i pranishëm.

Pika e parë e rendit të ditës është miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datave 13, 15, 17, 20, 21, 22, 27 dhe 28 maj të vitit 2019. Ka vërejtje nga kolegët për procesverbalet? Nëse nuk ka, miratohen procesverbalet e mbledhjeve të datave 13, 15, 17, 20, 21, 22, 27 dhe 28 maj 2019.

Pika e dytë e rendit të ditës është miratimi i draftkalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 3-21 qershor 2019. Sipas Rregullores, draftkalendarit trejavor i punimeve të komisionit reflekton kalendarin e punimeve të Kuvendit. Ka sugjerime për kalendarin? Siç e dini, gjatë muajit qershor do të ketë dy seanca plenare, një në datën 13 dhe një në datën 20.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk ka.

Jeni dakord me draftkalendarin?

Miratohet edhe pika e dytë e rendit të ditës.

Pika e tretë e rendit të ditës është shqyrtimi dhe miratimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Prokurorit të Përgjithshëm për vitin 2018”. Ne jemi komision përgjegjës për shqyrtimin dhe miratimin e kësaj projektrezolute. Kërkoj mirëkuptimin e kolegëve të komisionit që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për në mbledhjet e radhës, për arsye se relatorja, kolegja zonja Hysi, është në një aktivitet parlamentar jashtë Shqipërisë. Jemi dakord që ta shtyjmë për në mbledhjen e radhës pikën e tretë?

Dakord.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës, shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite, për shërbimet ajrore”. Ne jemi komision për dhënie mendimi, kurse relatore do të jetë kolegja Aurora Mara.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Energjetikës, zoti Ilir Bejtja, zëvendësministër, zonja Megi Xharo, përgjegjëse e marrëdhënieve me jashtë pranë ministrisë dhe

zonja Lilika Radovicka, përgjegjëse sektori, kurse për marrëveshjen tjetër kemi prezent zotin Luçi nga Ministria e Financave. Mirë se keni ardhur!

Zoti Bejtja, ju lutem bëni një prezantim të shkurtër të kësaj marrëveshjeje për kolegët e komisionit. Më pas do t'ia kaloj fjalën, relatores, zonjës Mara.

Fjala është për ju.

Ilir Bejtja – Përsëndetje zonja dhe zotërinj deputetë!

I nderuar zoti kryetar!

Kjo marrëveshje është miratuar me vendim qeverie në datën 9.1.2019 dhe është nënshkruar nga ambasadori ynë në Riad në datën 6.2.2019. Kjo marrëveshje ka për qëllim rritjen e bashkëpunimit dypalësh në fushën e transportit ajror, krijimin e kushteve të përshtatshme të ndërsjella dhe lehtësuese për operatorët e transportit të të dy vendeve, si dhe kalimin tranzit përmes territoreve të secilit vend, me qëllim lëvizjen pa pengesa për shtetasit e të dyja palëve kontraktuese. Marrëveshja vendos një kuadër rregullash dhe procedurash për funksionimin e shërbimit për transportin ndërkombëtar ajror të udhëtarëve, mallrave të postës, si dhe përcakton të drejtat e transportuesve ajror të të dyja palëve, bazuar si në JATA dhe në ICAO. Në marrëveshje parashikohen rregulla për të siguruar një zhvillim të koordinuar dhe liberalizim progresiv të transportit ndërmjet palëve, të mbështetur në nevojat reciproke komerciale dhe në kushtet e hyrjes në tregun e transportit ajror mbi dhënien e të drejtave për shërbimet ajrore ndërkombëtare të planifikuara, si dhe përcaktimin për autorizimet e përshtatshme për operim dhe njohjen e ndërsjellë të certifikatave dhe licencave në këtë fushë, mbi detyrimin e palëve për mbrojtjen e sigurisë në aviacionin civil ndaj akteve dhe ndërhyrjeve të paligjshme, në përputhje me konventat ndërkombëtare dhe në pajtim me dispozitat e sigurisë së aviacionit të vendosura nga ICAO, Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil, për sigurinë e palëve për garantimin e zbatueshmërisë së legjislacionit vendas gjatë qëndrimit në territorin përkatës, si dhe rregullat në rastet e lindjes së mosmarrëveshjeve të mundshme.

Gjithashtu, parashikohen terminologjitë dhe veprimi i ligjeve respektive, legjislacionit vendas tek ne dhe legjislacionit të Mbretërisë së Arabisë Saudite, si për transferimin e fitimit të parave, ashtu edhe me kryerjen e biznesit në mënyrë respektive në secilin prej vendeve.

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e shkëmbimit të notave diplomatike nga palët kontraktuese, ku secila nga palët njofton palën tjetër se kanë njoftuar procedurat e tyre të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të saj. Pra, ratifikimi është i domosdoshëm paraprakisht.

Zbatimi i kësaj marrëveshje nuk ka afekte financiare. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është autoriteti përgjegjës për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, e cila është një hap përpara në qasjen politike për bashkëpunimin e koordinuar në fushën e aviacionit. Janë marrë mendimet e Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe jemi sot për ta prezantuar.

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Bejtja!

Po, zonja Mara.

Aurora Mara – Përshëndetje të nderuar kolegë!

Përshëndetje kolegë të Ministrisë së Infrastrukturës!

Faleminderit për realitimin! Ishte shumë i qartë.

Unë dua t'ju bëj me dije kolegëve që në tryezë kemi relacionin e ministrisë, kemi vendimin nr. 211/2019, të Këshillit të Ministrave, për propozimin e projektligjit, kemi projektligjin që do të miratojmë sot nëse do të biem dakord të gjithë, si dhe marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite.

Po filloj me relatimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite, për shërbimet ajrore”.

Të nderuar anëtarë të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Në bazë të Kalendarit të Punimeve të Kuvendit dhe Kalendarit të Punës të Komisionit, jam caktuar relatore për projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite, për shërbimet ajrore”. Ne jemi komision për dhënie mendimi.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut e shqyrton këtë projektligj në zbatim të neneve 32 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit. Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave sipas përcaktimeve të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, kreu II, Marrëveshjet Ndërkombëtare, neni 121 i saj.

Qëllimi i projektligjit është ratifikimi i marrëveshjes për shërbimet ajrore, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhe Qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite

për të krijuar hapësira dhe mundësi më të mira për shtetasit e të dyja palëve për transport udhëtarësh, mallrash dhe dërgesash postare. Si shtet palë në Konventën mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar, Republika e Shqipërisë bart detyrimin që rrjedh nga kjo konventë për koordinimin e veprimtarisë në fushën e aviacionit civil dhe bashkëpunimin në fushën e transportit ajror, mbështetur në parimin e komunikimit ndërmjet vendeve.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje synon krijimin e kushteve lehtësuese, nëpërmjet të cilave do të bëhet e mundur lëvizja pa pengesa për shtetasit e të dy vendeve, si dhe do të rritet bashkëpunimi ndërmjet palëve. Marrëveshja, gjithashtu, vendos rregulla dhe parime prej të cilave do të drejtohet ky bashkëpunim dhe siguron një zhvillim progresiv transporti ndërmjet dy vendeve, të mbështetur në nevojat reciproke komerciale dhe kushtet e hyrjes në tregun e transportit ajror. Marrëveshja përbëhet nga 37 nene dhe nga shtojca “A”, në të cilën parashikohen linjat e specifikuar në të dy shtetet palë, ku përcaktohen linjat ajrore që kanë të drejtë të kryejnë shërbime ajrore ndërkombëtare të planifikuara në të dyja drejtimet.

Zbatimi i këtij projektligji nuk përmban efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit, ndërsa sa i takon përjashtimit nga detyrimet doganore dhe detyrimet e tjera, marrëveshja parashikon se çdo palë, në bazë të parimit të reciprocitetit, do të përjashtojë nga detyrimet doganore, taksat dhe detyrimet e tjera, një linjë ajrore të përcaktuar të palës tjetër, në masën më të plotë të mundur në bazë të ligjit të brendshëm.

Në aspektin ligjor, vlerësoj se projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjisllacionin në fuqi, kurse në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Gjithashtu, kam edhe disa pyetje për kolegët.

Cilat janë përfitimet konkrete të shtetit shqiptar nga ratifikimi i kësaj marrëveshjeje?

Kur mendohet që marrëveshja të jetë efektive dhe a ekzistojnë plane konkrete të detajuara në kohë?

A është kryer ndonjë analizë e detajuar apo studim tregu për të përcaktuar nëse një linjë e tillë do të ketë mjaftueshëm kërkesë në treg për t’i rezistuar kohës?

Në bazë të diskutimeve që do të bëhen, në fund do t’ju ftoj që ta votojmë projektligjin.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Si relatore ju duhet t’i ftoni kolegët të votojnë projekt marrëveshjen që kur bëni relatin.

Aurora Mara – Dakord, por mendova ta diskutojmë njëherë.

Ulsi Manja - Sipas Rregullores, relatorja na fton që të votojmë projekt marrëveshjen.

Faleminderit, zonja Mara! Meqenëse është relatimi juaj i parë, keni mirëkuptimin tonë. Urime për relatin tuaj të parë! Në fakt, me Kodin e ri të Sjelljes, duhet ta kisha thënë që në fillim.

Fjalën e ka zoti Bejtja për t'u përgjigjur. Pastaj do vazhdojmë me pyetje nga kolegë të tjerë.

Ilir Bejtja – Për sa u përket përfitimeve (unë i rendita pak më parë, por ndoshta duhet t'i shtjelloj në detaje), siguron një zhvillim të koordinuar dhe liberalizim progresiv të transportit midis palëve. Këtë marrëveshje nuk e fillojmë sot, por ka një akord midis dy qeverisë, të firmosur në 26.2.2014, që ka bërë të mundur njohjen respektive të të drejtave për transportin ajror të të dy vendeve, bazuar në zbatimin e standardeve të Aviacionit Civil Ndërkombëtar.

Sot ne u japim rrugë edhe disa elementeve të tjerë, që kanë të bëjnë me standardizimin e veprimeve në të dy vendet respektive, shkëmbimin e përvojës, standardizimin e regjistrimeve ekonomike dhe financiare midis tyre, unifikimin e taksave aeroportuale të të dyja palëve, përcaktimin e një strategjie, bazuar në analizën që është bërë ndër këto vite për të pasur një lëvizje me flukse më të koordinuara dhe më të përcaktuara qartazi të fluturimeve. Pra, të kemi fluturime direkte mes palëve dhe jo thjesht tranzit. Të gjitha këto janë, si në çdo linjë tjetër, përcaktimet e përfitimeve të palëve nga njëra-tjetra.

Nëse këto do të bëhen me kompani private, patjetër që përfitimet janë të kompanive private, kurse përfitimet e shtetit në këtë rast janë fluturimi, standardet dhe taksat aeroportuale që merr secila palë. Efektive bëhet menjëherë pas shkëmbimit të notave. Pra, miratohet marrëveshja në të dy parlamentet dhe pas shkëmbimit të notave qeveritare fillojmë lidhjen efektive.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti zëvendësministër!

Ka pyetje tjetër nga kolegët?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ilir Bejtja - Për sa u përket përfitimeve, si në çdo linjë, shkëmbimet midis palëve do të intensifikohen, lëvizja e njerëzve do të bëhet më e lehtë ...

Bashkim Fino – Do të filloj linja, do të ketë në vazhdimësi punë apo ...?

Ulsi Manja – Po.

Megi Xharo - Faleminderit, zoti kryetar!

Për sa i përket studimit të tregut, duhet të kemi parasysh që ka një palë që inicion marrëveshjen. Praktikisht, kjo marrëveshje është iniciuar nga pala arabe që në vitin 2014. Ndërkohë, ajo që është e rëndësishme dhe që duhet të theksojmë është që menjëherë pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, e cila, siç tha zëvendësministri u nënshkrua nga ambasadori ynë në shkurt, në Riad, gjatë muajit prill një prej kompanive më të mëdha arabe lawcost ka ardhur në Shqipëri dhe ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi, i cili parashikon vijimin e fluturimeve. Prej tyre ishte bërë një analizë e mirëfilltë dhe i është paraqitur ministres. Ne presim që gjatë fluksit veror të fluturimeve të fillojë operimet kompania FLYNAS. Kjo ishte një nga risitë pas kësaj marrëveshjeje.

Ulsi Manja- A ka pyetje nga kolegët?

Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni- Zoti kryetar, unë nuk mund të ndalem në përfitimet që mund t'i vijnë Republikës së Shqipërisë nga kjo, sepse ne jemi komision për dhënie mendimi dhe të mos hyjmë kaq thellë. Unë do të uroja që ne të kishim reciprocitet të plotë në këtë marrëveshje dhe të arrijmë ditët që edhe avionët e kompanive shqiptare të tejkalojnë hapësirën e Arabisë Saudite pa u ulur atje, pra që do të thotë të jenë të aftë të kryejnë fluturime të largëta. Gjithashtu, uroj të krijojmë kompani të fuqishme, të cilat pa marrë fare me qira avionë të jenë në gjendje të bëjnë këto udhëtime.

Unë kam një pyetje lidhur me detyrimet doganore. Në nenin 20 përcaktoni se bagazhet dhe ngarkesat në transit të drejtpërdrejtë do të përjashtohen nga çdo detyrim doganor. A e keni konsultuar me Doganën këtë, meqë janë edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Financave, sepse më duket përtej mundësive. Më duket se po tejkaloni Kodin Doganor, i cili ka disa procedura. Nëse tejkaloni Marrëveshjet me BE-në, Marrëveshjen e Stabilizim -Asociimit, MSA, ose ndonjë marrëveshje tjetër, dua ta shikoni këtë nëse i jeni referuar saktë.

Ilir Bejtja- Bëhet fjalë për mallrat transit, të cilat nuk hyjnë në territorin shqiptar, pra në fluturimet transit vetëm ndalojnë të ndërrojnë karburant, përveç kontrollit fizik, nëse ata do të shkarkohen në Shqipëri dhe të mund të magazinohen në magazinë doganore, ose skanimit, absolutisht asnjë lloj detyrimi nuk i nënshtrohen, sepse janë transit, nuk futen në territorin e Shqipërisë. Për këtë është shprehur Ministria e Financave pa rezerva.

Adriatik Alimadhi – Nëse mundem, dua të di nga cila palë është bërë marrëveshja, nga qeveria shqiptare, apo nga pala tjetër?

Ilir Bejtja- Siç ju thashë, në shkurt të vitit 2014 të dy qeveritë kanë rënë dakord për nënshkrimin e një akordi ose marrëveshjeje për shërbimet ajrore, pastaj është zgjatur deri në vitin 2019 për probleme të vetë Arabisë Saudite. Ne jemi një hap para tyre, deri sa kanë rifilluar negociatat për t'u nënshkruar nga ministri ynë në Riad në shkurt të vitit 2019.

Ulsi Manja– A ka pyetje të tjera?

Diskutime? Nuk ka.

Atëherë, kalojmë në votimin në parim të këtij projektligji.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? 1 kundër. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në shqyrtimin dhe votimin nen për nen.

Neni 1. Pro ? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Pro ? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Pro ? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Raporti i Komisionit të Ligjeve t'i përcillet komisionit përgjegjës e pastaj seancës plenare.

Zoti Bejtja, faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 03.06.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), për bërjen palë në kuadrin gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar mbi erozionin e bazës së tatueshme dhe transferimin e fitimit (BEPS)”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Elena Xhina, Fatmir Xhafaj, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Aurora Mara, Adriatik Alimadhi dhe Ediola Braha

Mungojnë:

Vasilika Hysi, Edmond Leka, Damian Gjiknuri, Spartak Braho, Alban Zeneli, Andi Permeti, Elda Hoti dhe Tom Doshi

Të ftuar:

Erion Luçi – zëvendësministër i Financave

Ulsi Manja - Kalojmë në pikën e pestë dhe të fundit të rendit të ditës në shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik OECD për bërjen palë në kuadrin gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar për erozionin e bazës së tatueshme dhe transferimin e fitimit BEPS”.

Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Përsëri relatore do të kemi kolegen Mara dhe prezent nga Ministria e Financave kemi zëvendësministrin e Financave, zotin Erion Luçi.

Zoti Luçi, një prezantim të shkurtër të kësaj projekt marrëveshjeje, pastaj, zonja Mara, do të flasë shkurtimisht lidhur me përputhshmërinë me Kushtetutën.

Erion Luçi – Faleminderit, zoti kryetar!

Kjo është një iniciativë e nisur nga liderët e G20-ës, kryesisht nga rastet që janë vënë re për shmangien e taksave prej zbatimit jo të harmonizuar të rregullave mes vendeve. Pas kësaj iniciative, e cila kaloi edhe në një nivel dakordësie të G20-ës dhe BE-së, u ngarkua OECD-ja për të zbatuar këtë lloj traktati. Si kohë për të nënshkruar këtë traktat, të cilin edhe BE-ja e ka vendosur si kusht për të gjitha vendet, edhe vendet jashtë BE-së, është fundi i këtij viti, kështu që miratimi që po bëjmë ne tani është miratimi në parim i kësaj dakordësie marrë në këtë nivel të lartë.

Si objektiva kryesore do të përmendja: përforcimin e koherencës së rregullave të tatiomit mbi të ardhurat e korporatave në nivel ndërkombëtar, lidhja e tatiomit me përmbajtjen e aktiviteteve ekonomike të realizuara, si edhe përmirësimi i transparencës.

Nuk po u hyj detajeve, sepse ne do të vijmë përsëri në komision për të sqaruar gjëra më të detajuara.

Sa i përket kësaj marrëveshjeje ose traktati, unë do të thosha që kjo i hap rrugën edhe marrjes së një asistence nga OECD-ja, për të cilën ata kanë treguar disponueshmërinë e tyre për të na ndihmuar duke pasur parasysh që janë të gjitha vendet e botës që e synojnë këtë si asistencë, por, nga ana tjetër, kjo na ndihmon edhe ne për të shmangur rastet e shmangies nga taksat për vendin tonë. Në një aspekt të caktuar, përtej detyrimit që kemi për ta ratifikuar si dakordësi ose marrëveshje, ka shumë mundësi të jemi në anën atyre që do të përfitojnë nga kjo marrëveshje, kështu që do të doja t’ju thosha që miratimi i kësaj marrëveshjeje do t’i hapte rrugën e harmonizimit të marrëveshjeve bilaterale, si dhe mbështetjes që do të kemi si nga OECD-ja, ashtu edhe nga BE-ja, si vend i hapur për këtë lloj dakordësie. Në rast të kundërt BE-ja e ka bërë shumë të qartë që do të marrë masa nëse kjo dakordësi nuk është ratifikuar nga vendet e caktuara, siç

mund të jenë vendet kryesore partnere të tyre, pra do të krijojë një listë gri të vendeve që nuk e kanë ratifikuar këtë marrëveshje.

Ulsi Manja – Zonja Mara, keni fjalën.

Aurora Mara- Faleminderit!

Do të më suportoni edhe një herë, por do të flas shkurtimisht meqë zotëria e bëri relatimin shumë të saktë. Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78 dhe 83, pika, 1 dhe 121 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës, sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit. Projektligji i propozuar ka si qëllim ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik për bërjen palë në kuadrin gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar për erozionin në bazë të tatueshme dhe transferimin e fitimit.

Kjo marrëveshje ka për qëllim pjesëmarrjen e Shqipërisë në kuadrin gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar për erozionin në bazë të tatueshme dhe transferimin e fitimit, duke i mundësuar që të punojnë në mënyrë të barabartë me vendet e tjera anëtare në trajtimin e shmangies tatimore, në përmirësimin e koherencës së rregullave të marrëveshjeve tatimore dhe në sigurimin e një ambienti tatimor sa më transparent. Duke qenë pjesë e kuadrit gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar, vendet anëtare marrin angazhimin për sa i përket plotësimit të standardeve minimale të paketës. Kjo paketë në total përmbledh 15 plane veprimi, por këto vende nuk janë të detyruara që t'i plotësojnë të 15-a planet e veprimit. Pra angazhimi është plotësimi i standardeve minimale të kësaj pakete.

Për bërjen palë të Republikës së Shqipërisë në kuadrin gjithëpërfshirës të këtij projekti ndërkombëtar, do të paguhet një kuotë anëtarësie prej 20 200 eurosh në vit dhe kjo vlerë do të rregullohet me inflacionin vjetor përkatës nga ana e organizatës. Marrëveshja është miratuar në parim me vendimin nr. 628, datë 26.10.2018 të Këshillit të Ministrave dhe është nënshkruar më 28.05.2019 në hapjen e takimit të shtatë të projektit të organizatës.

Projektligji parashikohet të hyjë në fuqi pas ratifikimit, pranimit nga palët pjesëmarrëse në përputhje me procedurat e tyre të brendshme.

Unë kam tri çështje për të diskutuar dhe për t'i qartësuar me kolegët.

Në aspektin procedural projektligji për ratifikimin e marrëveshjes duhej të ishte më i shoqëruar me tekstin e nënshkruar të marrëveshjes nga palët pjesëmarrëse, në fakt, ne nuk e kemi

marrëveshjen, si dhe me përkthimin e certifikuar nga Ministria e Drejtësisë, referuar përcaktimeve të nenit 43/2016 të marrëveshjes ndërkombëtare.

Shqipëria ka marrë dy ftesa nga Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik për t'iu bashkuar kuadrit gjithëpërfshirës të këtij projekti ndërkombëtar, e para, në maj të vitit 2016 dhe, e dyta, në mars të vitit 2018. Cila është arsyeja që Ministria e Ekonomisë dhe Financave nuk i është përgjigjur pozitivisht ftesës së parë, sepse të dytës i jeni përgjigjur?

Projektligji paraqitet i shoqëruar me planin e veprimit i përbërë nga 15 masa, i cili është objekt i ratifikimit nga Kuvendi, pasi Shqipëria nuk është e detyruar të plotësojë të gjitha masat e këtij plani veprimi, por vetëm standardet minimale të tij. Cilat janë këto standarde minimale që duhet t'i plotësojnë?

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Mara!

Aurora Mara – Më falni, që të përmirësoj relatimin e parë.

Së fundi, si relatore vlerësoj rëndësinë e miratimit të këtij projektligji në përmbushje edhe të angazhimit të Shqipërisë ndaj Komisionit Europian, pasi vendi ynë do të jetë pjesë e kuadrit gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar në vitin 2019, prandaj ju kërkoj kolegëve ta miratojmë atë në komision.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Mara!

Zoti Luçi, ju lutem, një përgjigje për pyetjet e koleges Mara!

Më pas fjalën e kanë kolegët për pyetje.

Erion Luçi – Së pari, ju kërkoj ndjesë se nuk e kam ndjekur me detaje, por më shumë në një aspekt të përgjithshëm dhe nuk e di nëse teksti i marrëveshjes, nuk jam i sigurt nëse është në këtë fazë i miratueshëm, por do ta shoh nëse është finalizuar, sepse kjo ia hap më shumë rrugën ecjes përpara marrëveshjes.

Sa i takon ftesës, edhe për këtë nuk jam i sigurt nëse ishte hera e parë apo e dytë, pasi ajo mund të ketë qenë thjesht një çështje logjistike, por as për këtë nuk kam ndonjë informacion. Pra, *deadline*, nuk është se është refuzuar kërkesa e parë, por është thjesht çështja për të kapur fundit e vitit dhe fakti që jemi këtu tregon se jemi ende në kohë.

Sa u takon çështjeve minimale, ky është një proces relativisht kompleks, pasi do të kalojë në disa negociata të tjera dhe pikërisht kjo që do të miratojmë sot do t'i hapë rrugë këtij procesi për të parë se çfarë mund të bëhet në bazë të rekomandimeve të OECD-së. Kjo procedurë është komplekse, pasi në të përfshihen të gjitha vendet e botës, përveç BE-së, kështu që do të ketë pika të nxehta jo vetëm nga ana jonë, por edhe nga vende të tjera, të cilat mund të duan ndonjë gjë tjetër, pasi diçka mund të ketë standard minimal e diçka tjetër jo.

Pra, jemi ende në një fazë relativisht paraprake ku më shumë shprehet dëshira apo vullneti për ta nisur një iniciativë të tillë, por nuk jemi ende te pjesa ku çdo detaj është i përcaktuar. Sa u takon edhe 15 planeve të masave që po diskutohen ato janë më shumë indikative, nuk janë ende detyruese, prandaj në çastin që ato do të bëhen detyruese, kam përshtypjen se do të kemi prapë nevojë për të ardhur në parlament për t'i ratifikuar dhe për t'i votuar.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Luçi!

A keni pyetje të tjera, zonja Mara?

Aurora Mara – Dua të shtoj vetëm diçka. Qëllimi i pasjes para syve i marrëveshjes ishte pikërisht për të nxjerrë konkluzionin për këto standarde minimale që duhet të plotësojmë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Mara!

A ka pyetje të tjera nga kolegët?

Po, zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Në nenin 2 flitet për një taksë që duhet ta paguajë Shqipëria si vend anëtar, si kuotizacion në vit. Dua të di se cilat janë interesat apo prioritetet e Shqipërisë në këtë rast?

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Alimadhi!

Zoti Luçi, një përgjigje për pyetjen e zotit Alimadhi.

Erion Luçi – Siç jua thashë pak më parë, nëse themi që ne nuk e ratifikojmë këtë marrëveshje, shumën prej 20 000, që është një shumë simbolike për anëtarësimin, duhet ta marrim edhe në formën e ndihmës legale që do të na japë OECD-ja për ta harmonizuar pjesën tonë të marrëveshjeve të taksave të dyfishta, por është relativisht e rëndësishme për të shmangur edhe kalimin në një kategori të favorshme për marrëdhënien me BE-në.

Ata e kanë thënë hapur që, nëse kjo marrëveshje nuk nënshkruhet brenda vitit 2019, atëherë të gjithë ato vende, edhe vendi ynë, do të trajtohen si vende të treta në aspektin e tregtisë apo të lehtësirave të tjera që ne mund të kemi për momentin me Bashkimin Europian. Pra, në

shumë aspekte kjo është një kosto minimale në krahasim me marrëdhëniet që ne kemi me Bashkimin European dhe me vendet e tjera të OECD-së.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Luçi!

A ka pyetje të tjera nga kolegët?

Nuk ka.

Kalojmë në votimin në parim.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes me shkëmbim notash ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), për bërjen palë në kuadrin gjithëpërfshirës të projektit ndërkombëtar mbi erozionin e bazës së tatueshme dhe transferimin e fitimit (BEPS)”.

Kalojmë në shqyrtimin dhe miratimin nen për nen.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet

Neni 3. Pro. Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji.

Ftoj relatoren dhe këshilltaren të bëjnë gati raportin për komisionin përgjegjës dhe më pas për seancën plenare.

Me miratimin e kësaj marrëveshjeje mbyllim mbledhjen e komisionit.

Shumë faleminderit për prezencën!

Ju uroj një ditë dhe javë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA